

Flamurtari/ Gjoka pa tre titullare me Lushnjen

nga AlbaniaSoccer

E premte, 08 Nentor 2013 22:17



Flamurtari pas dy fitoreve rradhazi do te rikthehet te luaj ne Vlore. Lushnja eshte kundertshtari i skuadres vlonjate qe kete takim do te kete probleme te medha. Trajneri Ernest Gjoka po mendon te zevendesoje lojtaret qe nuk do te kete ne dispozicion. Kapiteni Franc Veliu ka demtuar gjurin dhe nuk dihet kur do te kthehet ndersa Arbri dhe Lena nuk jane te mundshem per shkak skualifikimi me kartona. Megjithate Gjoka ka besim te skuadra e tij pasi ka disa alternativa per te zevendesuar ata qe nuk jane.